

VENDIM
Nr. 10, datë 16.3.2015

PËR LICENCIMINSHA “UJËSJELLËS KANALIZIME KAVAJË”

Në mbështetje të nenit 14, pika 1/a, nenit 17 të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996 “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, si dhe vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 958, datë 6.5.2009, “Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licencë”, Komisioni Kombëtar Rregullator

VENDOSI:

1. Rinovim licence për efekt të përfundimit të afatit operatorit sh.a Ujësjiellës-Kanalizime Kavajë me:

Drejtues ligjor: Ndriçim Proj;
Drejtues teknik : Rexhep Vogli;
Drejtues teknik: Sali Vogli.

2. Operatori sh.a.“Ujësjiellës-Kanalizime Kavajë” autorizohet të kryejë veprimtarinë përkatëse të kualifikuar në kategoritë:

Kategoria A, për grumbullimin dhe shpër-ndarjen e ujit për konsum publik;
Kategoria B, për përpunimin e ujit për konsum publik;
Kategoria C, për largimin e ujërave të ndotura.

3. Zona e shërbimit të këtij operatori është bashkia Kavajë, komunat: Golem, Luz i Vogël, Lekaj, Helmas, Synej, Kryevindh.

4. Kjo licencë është e vlefshme për një periudhë 2-vjeçare deri më datë 15.3.2017.

KRYETARI
Avni Dervishi